



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 5466 prot.

Ballsh më, 31 . 10 .2024

VENDIM

Nr. 55 Datë 29 / 10 /2024

**“PËR
MIRATIMIN E DRAFT KONTRATËS SË DHURIMIT NDËRMJET SHOQATËS
SHQIPTARE PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN DHE BASHKISË
MALLAKASTËR**

Në zbatim të nenit 9, pika 1.6, gërma “a”, neni 34, pika 3, neni 35, pika 1, gërma “d”, neni 36, pika 2 dhe nenin 64, gërmat “a” dhe “gj” të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994, Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë “Kodi Civil i Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, shkresës me nr. 206 Prot., datë 15.10.2024 të Shoqatës Shqiptare për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin në lidhje me dhurimin e disa pajisjeve dhe materialeve në funksion të MZSH Mallakastër,

VENDOSI

1. Miratimin e draft kontratës së dhurimit ndërmjet Shoqatës Shqiptare për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin dhe Bashkisë Mallakastër mbi dhurimin e disa pajisjeve dhe materialeve në funksion të Sektorit të MZSH Mallakastër.
2. Miratimin e shpenzimeve të transportit në vlerën prej 200 000 lekësh të ciliat do të përballohen nga buxheti i Bashkisë Mallakastër.
3. Në momentin e dorëzimit të materialeve sipas kontratës, aktivet të transferohen në kontabilitetit të Sektorit të MZSH Mallakastër.
4. Ky vendim shoqërohet me draft kontratë dhurimi dhe listën e materialeve dhe pajisjeve sipas shkresës me nr. 206 Prot., datë 15.10.2024.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, pika 6 e ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

KRYETAR

Nexhmi Sula

